



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.69/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Bajram Rexhahmetaj duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës Instituti Demokratik i Kosovës(KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Alternativa, dega në Pejë, për shkak të vendosjes së panos në rrugë publik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.09.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e organizatës Instituti Demokratik i Kosovës(KDI), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.69/2017, të datës 26.09.2017, ndërsa subjektit politik Alternativa, dega në Pejë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 500.00 (pesëqindë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës me të cilën pretendon se me datën 26.09.2017, në rrugën “Mbretëresha Teuta” në Pejë, ishin vendosur pano i Anëtarit për Kuvendin Komunal në Pejë, i subjekti politik Alternativa, të vendosur në hapësirë publike. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Alternativa të datës 27.09.2017, ka theksuar se kërkesa ë tillë është tendencioze dhe jo e mbështetur në ligj dhe rregulloren përkatëse, prapseprap kemi vepruar sipas ultimatimit të juaj duke ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës mirëpo në ditët në vijim do të parashtrojmë ankesë që ultimatumi i juaj ka qenë i pa bazë ligjërisht. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku është larguar pano.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se pano i kandidatit për Anëtar për Kuvendin Komunalë në Pejë, nga radhët e subjektit politik Alternativa, janë vendosur ne hapësira publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin

33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Alternativa, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që pano i kandidatit për Anëtar për Kuvendin Komunalë në Pejë, nga subjektit politik Alternativa, janë vendosur në hapësira publik përkatësisht në sheshin qendror të qytetit të Pejës.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Alternativa është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti pano i kandidatit të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr panon nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr. 69/2017 më datën 27.09.2017.

**Kryesuese e Panelit**

**Gyltene Sylejmani**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.***

